



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development


STRATEGJIA PËR ZHVILLIMIN E PYLLTARISË NË KOSOVË

2022-2030



STRATEGJIA PËR ZHVILLIMIN E PYLLTARISË NË KOSOVË

2022 - 2030



Prishtinë, dhjetor 2021

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
1. HYRJE	9
2. METODOLOGJIA	10
3. GJENDJA E PYJEVE NË KOSOVË	11
3.1 Shtrirja e pyjeve dhe kushtet.....	11
3.2 Shëndeti dhe vitaliteti i pyjeve	11
3.3 Mjedi dhe biodiversiteti.....	12
3.4 Prodhimi pyjor	13
3.5 Politikat, Legjislacioni dhe Korniza institucionale.....	14
Politikat dhe Strategjitë.....	14
Legjislacioni	15
Institucionet	16
Institucionet qeveritare.....	17
Institucionet joqeveritare.....	17
SWOT ANALIZA.....	17
4. SYNIMET DHE OBJEKTIVAT	19
Deklarata politike	19
Parimet	19
Çështjet gjinore	19
Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (ozhq).....	20
Synimi i përgjithshëm.....	20
Objektivi strategjik 1: Përmirësimi i gjendjes së resurseve pyjore	21
Objektivi specifik 1.1: Rishikimi dhe përditësimi i kornizës ligjore për pylltarinë.....	21
Objektivi Specifik 1.2: Pyjet publike administrohen me plane menaxhuese afatgjatë.....	21
Objektivi specifik 1.3: Të dhënat për resurse pyjore të përditësuara dhe në dispozicion.....	21
Objektivi specifik 1.4: Vendosja e bazës së kadastrës së tokave pyjore	21
Objektivi Specifik 1.5: Hartëzimi i pyjeve sipas funksioneve	21
Objektivi specifik 1.6: Shtimi i sipërfaqeve pyjore	22
Objektivi Specifik 1.7: Rritja e prodhimit të farërave dhe fidanëve pyjor	22
Objektivi Specifik 1.8: Përmirësimi i pyjeve me anë të masave silvikulturore.....	22
Objektivi strategjik 2: Mbrojtja e resurseve pyjore	22
Objektivi specifik 2.1: Zvogëlimi i ndërhyrjeve joligjore në pyje.....	22

Objektivi specifik 2.2: Konsolidimi i tokave pyjore të fragmentuara	23
Objektivi specifik 2.3: Monitorimi dhe mbrojtja e shëndetit të pyjeve	23
Objektivi Specifik 2.4: Ruajtja e biodiversitetit në pyjet prodhuese	23
Objektivi specifik 2.5: Mbrojtja e pyjeve nga zjarret	23
Objektivi strategjik 3: Përdorimi i qëndrueshëm dhe shumëqëllimor i resurseve pyjore.....	23
Objektivi specifik 3.1 Shtimi i prerjeve të rregullta në pyje	24
Objektivi Specifik 3.2: Përkufizimi dhe zbatimi i kriterëve dhe treguesve të Menaxhimit të Qëndrueshëm të Pyjeve (MQP)	24
Objektivi specifik 3.3 Shfrytëzimi i qëndrueshëm i PPJD	24
Objektivi specifik 3.4: Zhvillimi i qëndrueshëm i ekoturizmit	24
Objektivi strategjik 4: Ngritja e kapaciteteve.....	24
Objektivi specifik 4.1: Avancimi i arsimit formal në pylltari.....	24
Objektivi specifik 4.2: Krijimi i mundësive për aftësim profesional	25
Objektivi specifik 4.3: Fuqizimi i institucioneve përgjegjëse për administrim dhe menaxhim të pyjeve dhe gjuetisë	25
Objektivi specifik 4.4: Sektori privat mbështetet financiarisht dhe administrativisht.....	25
Objektivi strategjik 5: digjitalizimi dhe komunikimi.....	25
Objektivi specifik 5.1: Sistemi i informacionit pyjor është funksional	25
Objektivi specifik 5.2: Avancimi i komunikimit dhe ndërgjegjësimit në pylltari	25
5. ZBATIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI	26
6. NDIKIMI BUXHETOR I ZBATIMIT TË STRATEGJISË	26
Vlerësimi i kostos së përgjithshme të zbatimit të SZHP-së, 2022 – 2030	28

SHKURTESAT

AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
APK	Agjencia Pyjore e Kosovës
DP	Departamenti i Pylltarisë
FAO	Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara
IHP	Instituti për Hulumtime Pyjore
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MRIB	Menaxhimi dhe Raportimi i Informatave mbi Biodiversitetin (GIZ-2017)
NFI	Inventarizimi Kombëtar i Pyjeve
NLBI	Instrumenti, ligjërisht Jodetyrimor për Pylltarinë (OKB, 2007)
NSH	Ndërmarrje Shoqërore
PBZHR	Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020 (I përditesuar në vitin 2019)
PKVER	Plani Kombëtar i Veprimit për Energjinë e Ripërtëritshme (2011-2020)
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim (2016-2021)
SNK	Strategjia për Ndryshimet Klimatike e Kosovës (2019-2028)
SZHP	Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë (2010-2020)
UNSPF	Plani Strategjik për Pylltarinë i Kombeve të Bashkuara (2017-2030)

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përveç rolit jetik në zbutjen e ndryshimeve klimatike, të qenët vatër e pjesës më të madhe të biodiversitetit tokësor dhe në pengimin e degradimit të tokës, pyjet ofrojnë shumë mallra dhe shërbime, të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt në ekonominë kombëtare dhe në mirëqenien e komuniteteve rurale në veçanti. Përkundër tërë këtyre meritave, shpyllëzimi dhe degradimi i pyjeve kanë qenë për një kohë të gjatë në krye të agjendës globale mjedisore e zhvillimore, në përgjigje ndaj të cilave një varg debatesh ndërkombëtare dhe rajonale kanë synuar arritjen e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve. Instrumenti Ligjërishit Jodetyrimor (NLBI) për Pylltarinë i vitit 2007 dhe Plani Strategjik për Pylltarinë i Kombeve të Bashkuara (UNSPF) 2017-2030, janë rezultatet kryesore të këtyre debateve intensive dhe tregojnë qartë se si pyjet me funksionet e tyre ekonomike, ekologjike e shoqërore, mund të kontribuojnë në synimet e zhvillimit të qëndrueshëm (SZHQ).

Me pothuajse gjysmën e territorit të saj të mbuluar me pyje dhe e ndodhur brenda vatrave të biodiversitetit në Evropë, Kosova është gjithashtu duke u munduar të ndërtojë një ekonomi moderne. Zhvillimi i viseve rurale dhe zbutja e varfërisë, kanë rëndësi të konsiderueshme në kuadër të kësaj përpjekjeje. Nëse menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme, pyjet në Kosovë kanë potencial që të kontribuojnë në masë të madhe në jetesën e banorëve të viseve rurale, si dhe në ekonominë kombëtare, gjë që pasqyrohet edhe në Ligjin për Pyjet. Ligji parasheh që pyjet në Kosovë përbëjnë një resurs kombëtar dhe duhet të menaxhohen në mënyrë që krahas ofrimit të mallrave dhe shërbimeve, të ruhet edhe biodiversiteti për të mirën e brezave të tanishëm dhe atyre të ardhshëm.

Si pasojë e kushteve të pafavorshme dhe praktikave të paqëndrueshme, pyjet e Kosovës nuk e kanë përmbushur deri më tash rolin e tyre në nivelin e pritur, dhe pikërisht kjo përbën bazën e kësaj Strategjie për Zhvillimin e Pylltarisë (SZHP) për 2022-2030. E strukturuar dhe e përgatitur sipas qasjes evropiane, SZHP-ja, përfaqëson një përpjekje për t'i mbrojtur resurset pyjore dhe për të promovuar menaxhimin e tyre të qëndrueshëm në Kosovë. Tejvështimet e ofruara nga kjo SZHP janë zhvilluar në bazë të pikëpamjeve të përbashkëta të palëve të interesit që morën pjesë aktivisht në procesin e hartimit. Kapacitetet e ulëta teknike dhe institucionale, infrastruktura joadekuate, bashkërendimi dhe bashkëpunimi i pasuksesshëm ndërmjet institucioneve përkatëse, si dhe zbatimi jo i duhur i ligjit, janë shkaktarët kryesorë të degradimit të pyjeve, përkeqësuar më tej edhe nga varfëria dhe qasja e pamjaftueshme në burime të energjisë në viset rurale. Për më tepër, ka edhe mbivendosje e boshllëqe në kornizën ligjore për pyjet, e këto veç sa i rrisin problemet. Prerja e pakontrolluar për dru zjarri, nga ana tjetër, çon në humbje të konsiderueshme ekonomike, pasi kjo masë drusore do të ishte tejet e vlefshme për industrinë pyjore dhe do të rriste kontributin e pyjeve në ekonominë e vendit përmes planeve të integruara të menaxhimit të pyjeve, të mbështetura me sisteme të fuqishme të mbrojtjes së pyjeve.

Synimi parësor i SZHP-së, është që të ruajë, të zgjerojë dhe të sigurojë menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve pyjore të Kosovës, me qëllim që të kontribuojnë në ekonominë kombëtare. Kjo do të bëhet duke ruajtur ekuilibrin ndërmjet funksioneve ekonomike, ekologjike dhe shoqërore të pyjeve. Të gjitha objektivat strategjike janë përcaktuar ashtu që të ndihmojnë drejt përmbushjes së këtij synimi të përgjithshëm në periudhën dhjetëvjeçare. Plani i veprimit është përgatitur për periudhën e parë trevjeçare. Rezultatet dhe realizimi i planit të veprimit, do të shërbejnë si udhërrëfyes për përgatitjen e planeve të veprimit për periudhat pasuese.

Strategjia i ka pesë objektiva strategjike, si më poshtë:

- 1- Përmirësimi i gjendjes së resurseve pyjore
- 2- Mbrojtja e resurseve pyjore
- 3- Përdorimi i qëndrueshëm dhe shumë funksional i resurseve pyjore
- 4- Zhvillimi i kapaciteteve të sektorit të pylltarisë
- 5- Digjitalizimi dhe përmirësimi i komunikimit

Objektivi i parë strategjik është përmirësimi i pyjeve të Kosovës. Shtimi dhe kujdesi i duhur për resurset pyjore është i domosdoshëm për të siguruar kontributin e pritur të sektorit të pylltarisë në ekonominë kombëtare dhe kjo varet në masë të madhe nga struktura e duhur menaxhuese. Prandaj, objektivi i parë strategjik përqendrohet në përmirësimin e legjislacionit lidhur me pylltarinë, inventarizimin e pyjeve dhe sistemin e planifikimit të menaxhimit.

Aktivitetet kryesore në kuadër të këtij objektivi janë të dy kategorive: institucionale dhe teknike. Përmirësimi i kornizës ligjore lidhur me pylltarinë, do të bëhet duke analizuar fillimisht kontekstin aktual, e pastaj duke hartuar ligjin për pyjet dhe aktet nënligjore përcjellëse. Temat kryesore të punës do të përfshijnë çështjet e pronësisë, ndërrimin e destinimit, kontratat, licencat, qiradhënien dhe kadastrën. Gjithashtu, është përfshirë një aktivitet i veçantë për demonstrimin e humbjes ekonomike, si pasojë e prerjeve të paligjshme.

Nga aspekti teknik, përfundimi i planeve menaxhuese të pyjeve dhe rifreskimi i inventarizimit kombëtar të pyjeve, janë aktivitetet kryesore. Kjo do të përcillet me përgatitjen e hartave të pyjeve me shtresa funksionale dhe veçori të tjera të nevojshme, siç është regjistri. Do të përmirësohet dhe do të rritet prodhimi i farërave dhe fidanëve të drurëve pyjorë, më qëllim të mundësimit të aktiviteteve të planifikuara të pyllëzimit dhe ripyllëzimit. Do të bëhet përkujdesja e duhur për grumbujt e rinj pyjorë përmes masave të nevojshme silvikulturore, ndërsa nën-ngastrat e degraduara do të sanohen.

Objektivi i dytë strategjik parasheh mbrojtjen e resurseve pyjore. Aranzhimet ligjore dhe krijimi i Task-Forcës për ligjshmërinë e shfrytëzimit të drurit, janë aktivitete të vendosura bashkërisht e që do të mbështeten me pajisje dhe trajnime. Gjithashtu, do të analizohet dhe hartëzohet zinxhiri i vlerave pyjore. Sipërfaqet e fragmentuara të pyjeve private dhe publike, si dhe konsolidimi i tyre, janë ndër aktivitetet që do të përfshijnë verifikimin dhe regjistrimin e kufijve të tyre. Një grup tjetër aktiviteteesh janë ato që ndërlidhen me shëndetin e resurseve pyjore dhe biodiversitetin pyjor. Kapacitetet për monitorimin e dëmtuesve dhe sëmundjeve të pyjeve do të rriten, ndërsa do të organizohen edhe trajnime në vendin e punës dhe do të lehtësohet shkëmbimi ndërkufitar i informatave. Tutje, llojet e rralla dhe të rrezikuara do të identifikohen dhe mbrohen. Do të bëhet inventarizimi i biodiversitetit dhe rezultatet e tij do të përfshihen në planet menaxhuese të pyjeve. Dihet që ndryshimet klimatike mund të çojnë në rritjen e rasteve të zjarreve pyjore, prandaj janë paraparë aktivitete që synojnë zhvillimin e kapaciteteve për parandalimin dhe luftimin e zjarreve pyjore, me theks në krijimin e një sistemi, mbështetur me trajnime dhe pajisje.

Duke pasur parasysh faktin që mallrat dhe shërbimet e siguruar nga pyjet e Kosovës janë shumë më të vogla se sa potenciali i tyre, objektivi i tretë strategjik i kushtohet shtimit të vlerës së produkteve dhe shërbimeve drusore dhe jo-drusore. Do të thjeshtohet procedura teknike dhe administrative për shfrytëzimin e pyjeve, ndërsa do të rregullohen siç duhet edhe lejet afatgjata të prerjes. Do të përmirësohen kapacitetet teknike të stafit të pylltarisë sa i përket monitorimit, inventarizimit, mbledhjes dhe përpunimit të produkteve pyjore jo-drusore. Do të identifikohen tregjet për produktet

vendore dhe zonat potenciale për ekoturizëm. Gjithashtu, do të identifikohen boshllëqet në legjislacion lidhur me produktet dhe shërbimet pyjore jo-drusore, si dhe do të plotësohen me ndryshimet e nevojshme. Në kuadër të këtij objekti, do të themelohet edhe një qendër informuese.

Një tjetër grup aktiviteteve të rëndësishme në kuadër të objektivit të tretë ka të bëjë me përkufizimin dhe zbatimin e kriterëve dhe treguesve kombëtarë të Menaxhimit të Qëndrueshëm të Pyjeve (MQP) në Kosovë. Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi për gjendjen dhe trendët e sektorit të pylltarisë me anë të të dhënave të verifikuara dhe në mënyrë pjesëmarrëse, padyshim që do të jetë ndihmesë për mekanizmin vendimmarrës për planifikime të ardhshme. Zbatimi i kriterëve dhe treguesve të MQP-së, ka potencialin që të japë një sërë kontributesh drejt sigurimit të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve kur aplikohen në nivelin lokal. Prandaj, do të bëhet një studim pilotues në njërin prej rajoneve.

Objektivi i katërt strategjik ka të bëjë me zhvillimin e kapaciteteve, duke u përqendruar në shkollimin formal dhe aftësimin profesional. Ndarja e bursave dhe mundësitë e shkollimit në vendet evropiane, janë ndër aktivitetet kryesore. Gjithashtu, do të hapet një shkollë e mesme profesionale dhe do të realizohen programe trajnime në qendrat rajonale të aftësimin profesional.

Çështjet e pylltarisë dhe të gjuetisë do të adresohen në kuadër të objektivit të katërt strategjik. Do të vlerësohen nevojat për riorganizim dhe në bazë të tyre do të përcaktohet një strukturë e re. Do të lehtësohet bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informatave në nivelin ndërkombëtar. Gjithashtu, do të zhvillohen dhe realizohen trajnime për stafin e pylltarisë.

Digjitalizimi i të dhënave pyjore dhe përmirësimi i komunikimit do të adresohen përmes objektivit të pestë. Funkcionalizimi dhe mirëmbajtja e sistemit informativ të pyjeve të Kosovës (SIPK) që veç ekziston, është synim strategjik i këtij objekti. Në këtë drejtim, do të përditësohen modulet e SIPK-ut, do të krijohet njësi për administrimin e SIPK-ut, do të ofrohen trajnime në vendin e punës, si dhe do të përgatitet udhëzuesi. Sa i përket përmirësimit të komunikimit, do të realizohet një sondazh i gjerë për të kuptuar këndvështrimet e segmenteve të ndryshme të shoqërisë dhe pastaj, në bazë të rezultateve të këtij sondazhi, do të përgatitet dhe zbatohet plani strategjik i komunikimit. Gjithashtu, do të organizohen fushata ndërgjegjësuese për nxënësit e shkollave të mesme dhe shkolla verore për nxënësit, si dhe do të realizohen fushata mediatike.

SZHP-ja, është plotësisht në harmoni me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) dhe strategji të tjera kombëtare, si dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të pylltarisë. Rezultatet e samitit të mbajtur së fundmi në Paris, tregojnë që ka filluar një epokë e re, në të cilën çështjet e pylltarisë vihen në krye të agjendës globale. Rrjedhimisht, është e rëndësishme që të bëhen të gjitha përpjekjet e nevojshme për zbatimin e suksesshëm të SZHP-së. Faktori kyç për progres është komunikimi dhe bashkëpunimi efektiv me sektorët e tjerë në Kosovë, pasi shumica e aktiviteteve mund të realizohen me angazhimin dhe kontributin e sektorëve të ndërlidhur, duke përfshirë sektorin privat. Padyshim që vendosmëria dhe vullneti politik janë parakushte për këtë.

1. HYRJE

Mbrojtja e mjedisit është një prej çështjeve me prioritet e agjendës globale në 50 vitet e fundit. Duke vazhduar me këtë gjendje alarmuese, dëmtimi dhe degradimi i pyjeve janë ndër shkaktarët kryesorë të kësaj gjendjeje dhe janë në qendër të vëmendjes nëpër diskutimet ndërkombëtare. Tani dihet gjerësisht që pyjet, përveç rolit të tyre jetik në mirëqenien e njeriut, kur menaxhohen si duhet ato kontribuojnë në masë të madhe në parandalimin dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike, mbrojtjen e biodiversitetit dhe parandalimin e degradimit të tokës.

Në vazhdën e debatit intensiv ndërkombëtar mbi pylltarinë, OKB-ja, u pajtua për Instrumentin Ligjërishat Jodetyrimor për Pylltarinë (NLBI) në vitin 2007 dhe së fundmi përgatiti Planin Strategjik për Pylltarinë (UNSPF) për 2017-2030. Duke ofruar kështu një kornizë globale për veprime në të gjitha nivelet me qëllim të menaxhimit të qëndrueshëm të të gjitha llojeve të pyjeve dhe drurëve jashtë pyjeve, si dhe për të ndaluar shpyllëzimin dhe degradimin e pyjeve, UNSPF-ja, përcakton 6 synime globale për pyje, të ndërlidhura me 26 caqe që duhet të arrihen deri në vitin 2030. Pylltaria ka rol të rëndësishëm, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, në të 17-të, synimet e zhvillimit të qëndrueshëm, duke manifestuar veçoritë e saj në sasinë e vogël të karbonit dhe bazën biologjike që mundësojnë depozitim të karbonit dhe ofrim të shërbimeve miqësore ndaj mjedisit.

Kosova po i shtyn përpara proceset e reformimit për ndërtimin e një ekonomie bashkëkohore. Një prej segmenteve të rëndësishme të programit të Qeverisë është zhvillimi i viseve rurale dhe zbutja e varfërisë, gjë që i rrit pritjet lidhur me rritjen e të hyrave të ekonomive familjare rurale e të ndërmarrjeve të vogla, si dhe qëndrueshmërinë e komunave. Në këtë kontekst, funksionet ekonomike, shoqërore dhe ekologjike të pyjeve, janë të një rëndësie të konsiderueshme për zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës dhe për përmirësimin e cilësisë së jetës, veçanërisht në viset rurale dhe malore. Bazuar në funksionet shumëqëllimore të pyjeve, Kosova i sheh pyjet si pjesë e pasurisë/trashëgimisë kombëtare. Ligji për Pyje thekson që pyjet e Kosovës janë resurs kombëtar dhe duhet të menaxhohen në atë mënyrë që të sigurojë rendiment të çmuar, duke mbrojtur njëkohësisht biodiversitetin për të mirën e brezave të tanishëm dhe atyre të ardhshëm.

Duke pasur pothuajse 45 % të tokës së saj të mbuluar me pyje dhe duke qenë në një rënë prej vatrave kryesore të biodiversitetit të Evropës, Kosova ndërmori një hap të rëndësishëm në sektorin e pylltarisë me përgatitjen dhe zbatimin e Strategjisë për Zhvillimin e Pylltarisë (SZHP) 2010-2020. SZHP-ja, ishte një përpjekje e rëndësishme për ngritjen e kapaciteteve për adresimin e kushteve të pafavorshme dhe ndërprerjen e praktikave të paqëndrueshme aktuale. Pasi kjo ishte gjithashtu një përgjigje ndaj NLBI-së, që i fton vendet të përgatisin programe kombëtare pyjore, SZHP-ja, është e nevojshme që të përtërihet për periudhën 2022-2030, duke u bazuar në mësimet e nxjerra dhe mundësitë e reja të krijuara.

Në aspektin strategjik me politikat kombëtare të zhvillimit dhe në harmoni me politika dhe strategji të tjera sektoriale të ndërlidhura, Strategjia për Sektorin e Pylltarisë 2022-2030, është përgatitur në përputhje me Strategjinë e BE-së, për Pylltari 2020, për të mbrojtur burimet pyjore të Kosovës dhe për të promovuar menaxhimin e tyre të qëndrueshëm. SZHP-ja, 2022-2030 është strukturuar sipas kriterëve dhe qasjes të MQP-së, të dakorduara nga *Forest Europe (Pyjet e Evropës)*. Ajo merr parasysh skenarin e ardhshëm politik dhe socio-ekonomik të Kosovës, si dhe gjenerimin e teorisë së ndryshimit, e cila përshkruan hapat dhe lidhjet e tyre që do të çojnë në rezultatin e planifikuar.

2. METODOLOGJIA

Me mbështetjen e projektit GCP/KOS/007/SWE zbatuar nga FAO, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), ka ndërmarrë një aktivitet të gjerë, i përbërë prej një numri të studimeve dhe ngjarjeve me pjesëmarrje për hartimin e Strategjisë për Zhvillimin e Pylltarisë (SZHP) 2022-2030. Marrja në konsideratë e aspekteve gjinore, mësimet të nxjerra nga vlerësimi i zbatimit të SZHP-së, paraprahe si dhe nevojat e grupeve të interesit dhe atyre më të pa favorizuara, janë marrë parasysh.

Aktivitetet përgatitore kanë nisur me vlerësimin e zbatimit të Strategjisë për Zhvillimin e Pylltarisë në Republikën e Kosovës 2010-2020 (SZHP 2010-2020). Gjatë procesit u shqyrtuan dhe analizuan korniza ligjore ekzistuese, strukturat organizative dhe menaxheriale të pylltarisë, raportet e progresit të ndërlydhura me sektorin e pylltarisë, librat e gjelbër të MBPZHR-së, si dhe raportet e APK-së, dhe të DP-së. Gjithashtu, janë realizuar takime të ndryshme me institucionet përgjegjëse, ministritë e linjës, organizatat joqeveritare dhe palë të tjera të interesit.

Në shkurt 2021, MBPZHR-ja, formoi Grupin Punues Ndërmintor dhe nën-grupe punuese të përbëra nga përfaqësues të ministrive dhe organizatave kryesore për hartimin e SZHP-së, 2022-2030. Përmes analizave SWOT dhe me mbështetjen e ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë, nën-grupet punuese hartuan raporte për identifikimin e objektivave strategjike dhe specifike, si dhe propozuan veprime dhe projekte konkrete. Përgjatë procesit, u siguroi që çështjet gjinore të përfshihen plotësisht në analiza, objektiva dhe në projektet e propozuara.

Rezultatet e punës së nën-grupeve u prezantuan dhe analizuan në takimet e përbashkëta të grupit punues dhe punëtorive për Rishikimin e Përbashkët të Sektorit të Pylltarisë, me qëllim të diskutimit të strukturës dhe përmbajtjes së projekt-SZHP-së, 2022-2030 dhe të ofrimit të komenteve dhe propozimeve për përmirësime.

Pas një pune intensive dhe një sërë konsultimesh prej grupit punues, draft SZHP-së, 2022-2030, së bashku me planin e saj të veprimit janë nënshtruar diskutimeve dhe procedurave të parapara në udhëzimit administrativ (QRK) Nr.07/2018.

3. GJENDJA E PYJEVE NË KOSOVË

3.1 SHTRIRJA E PYJEVE DHE KUSHTET

Sipërfaqja pyjore përkufizohet si tokë me mbulesë kurorash druri prej më shumë se 10% dhe sipërfaqe më e madhe se 0.5 ha me drurë, që në fazën e pjekurisë mund ta arrijnë lartësinë minimale prej 5 metrash. Sipas Inventarizimit Kombëtar të Pyjeve (IKP), sipërfaqja pyjore e Kosovës është shtuar për 5% ndërmjet viteve 2002-2012, duke arritur në 481.000 ha (44.7% e sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës). Për nga pronësia, 62% e pyjeve janë në pronësi të shtetit, ndërsa pjesa tjetër është në pronësi të pronarëve privatë. Mbulesa me pyje në Kosovë është më e madhe se në vendet fqinje (28% në Shqipëri, 39% në Maqedoni, 40% në Mal të Zi dhe 31% në Serbi).

Në pyjet e Kosovës mbizotërojnë llojet e drurëve fletorë me 93% (449 400 ha). Mbi gjysma e pyjeve konsiderohen të moshës së njëjtë (një-moshe). Pyjet e llojeve halore mbulojnë afro 5% të sipërfaqes pyjore (23 800 ha). Gjithsej vëllimi në këmbë është 40,5 milionë m³(diametri >7cm në lartësi të gjoksit) dhe ka trend të qëndrueshëm. Rreth 18.5 milionë m³ të vëllimit në këmbë gjenden në pyjet e ahut (*Fagus sp.*), pasuar nga pyjet e dushkut me mbi 9 milionë m³. Vëllimi mesatar në këmbë për hektar i pyjeve në Kosovë është 84 m³ (mesatarja evropiane: 104 m³/ha). Gjithsej stoqet e karbonit llogariten të jenë mbi 24 milionë tonë. Pyjet cungishte mbulojnë 84% të gjithsej sipërfaqes pyjore dhe kryesisht menaxhohen me rotacione të shkurtra për prodhim të drurit si për ngrohje dhe nevoja tjera familjare.

Jo të gjitha njësitë menaxhuese pyjore (NjMP) kanë plane menaxhuese. Rreth 82% e pyjeve publike janë të mbuluara me plane menaxhuese. Aktualisht, pronarët e pyjeve private nuk përgatisin plane menaxhuese për pyjet e tyre. Madhësia mesatare e një pylli privat është rreth 1.4 ha.

3.2 SHËNDETI DHE VITALITETI I PYJEVE

Të dhënat sipas IKP-së, të fundit, tregojnë se gjithsej 58.200 ha pyje ndikohen negativisht nga faktorët biotikë dhe abiotikë, ku 5.8 milionë m³ dëmtohen si pasojë. Insektet dhe sëmundjet janë shkaktarë për dëmtimin e 14.600 ha të kësaj sipërfaqeje. Zjarret pyjore dëmtuan 12.200 ha, ndërsa kullotja e kafshëve 1.800 ha të tjerë. Dëme gjithashtu shkaktohen edhe nga faktorë të ndryshëm si thatësira dhe ngricat e faktorë të tjerë abiotikë. Prerja ilegale e pyjeve për qëllime komerciale është ndër shkaqet më të rëndësishme të dëmtimit të pyjeve. Fshatarët e varfër që jetojnë afër pyjeve, presin drunjtë për mbijetesë. Sipas inventarizimit të fundit kombëtar të pyjeve, 40% e pyjeve publike dhe 29% e pyjeve private në Kosovë, janë pre e aktiviteteve të pakontrolluara ose prerjeve joligjore. Vëllime të larta të mbetjeve pyjore shpesh mbesin në pyll pas prerjeve, gjë që çon në humbje të fibrës, dëmtime nga sulmet e insekteve dhe rrezik të shtuar nga zjarret pyjore.

Kryesisht shkaktimi i zjarreve dhe dëmtimi prej tyre i pyjeve vjen si pasojë e djegies së tokave bujqësore pas korrjes ose kullosave nga fermerët dhe blegtorët. Pakujdesia gjatë kampingut dhe piknikut, është një tjetër shkaktar i rëndësishëm i zjarreve pyjore. Në vitin 2020, rreth 2404 ha pyje u dëmtuan si pasojë e zjarreve. Është e qartë se nevojitet koordinim dhe bashkëpunim më i mirë ndërmjet APK-së, dhe autoriteteve lokale, për ndërgjegjësimin e tërë shoqërisë.

Cilësia dhe produktiviteti i pyjeve ekzistuese mbeten tejet shqetësuese për shkak të degradimit të vazhdueshëm. Erozioni i dheut është i përhapur në zonat malore me sinjale të theksuara të dëmtimit të pyjeve, mjedisit dhe biodiversitetit.

3.3 MJEDISI DHE BIODIVERSITETI

Me shumë lloje endemike dhe të rralla të florës dhe faunës, Kosova është një prej vendeve me biodiversitet të pasur në Evropë. Në dekadën e fundit janë bërë shumë aranzhime lidhur me caktimin e zonave të mbrojtura. Mirëpo, problemet janë të pranishme, në veçanti ato për shkak të kapaciteteve të ulëta financiare dhe teknike. Informatat mbi biodiversitetin vijnë nga studime të ndara të kryera nga subjekte të ndryshme. Mungon sistemi informativ funksional i bazuar në baza gjithëpërfshirëse të të dhënave, gjë që e vështirëson menaxhimin e duhur të biodiversitetit në Kosovë.

Studimet kanë treguar se nga 13 lloje endemike bimësh dhe 200 lloje që rriten në rajonin e Ballkanit, rreth 24 lloje kërcënohen nga aktivitetet e njeriut. Janë gjithashtu 46 lloje gjitarësh me rëndësi rajonale dhe globale. Si pasojë e shkatërrimit të ligatinave dhe të ndotjes e degradimit të lumenjve, disa prej llojeve të zogjve të ujit tashmë kanë humbur.

Shumica e sipërfaqes pyjore në Kosovë përbëhet nga grumbuj pyjor të përzier (21% e sipërfaqes pyjore përbëhet nga 4-5 lloje të ndryshme drurësh). Afro 85% e pyjeve rigjenerohen në mënyrë vegjetative përmes lastarëve të cungjeve. Rreth 0.5% rigjenerohen përmes farërave dhe vetëm 1% e pyjeve klasifikohen si të pyje të virgjëra (të pashkelura). Në Evropën Juglindore, shifra mesatare e pyjeve të pashkelura nga njeriu është 6%. Shkalla e pyllëzimeve gjithashtu është tejet më e ulët se në vendet fqinje me 1%.

Llojet jo-autoktone, të cilat përbëjnë kërcënim për pyjet natyrore të Kosovës, mbulojnë 0.6% të pyjeve. Lloji kryesor është akacia me prejardhje nga juglindja e SHBA-së, e cila fillimisht u soll në Evropë, pastaj edhe në Kosovë, me qëllim të kontrollimit të erozionit. Akacia mbulon 2400 ha bashkë me Larshin dhe Pseudocugën. Gjithsej sipërfaqja me specie jo-autoktone, sillet rreth 3,200 ha.

Vëllimi mesatar i drurëve të thatë është 3.6 m³ për hektar, që është tejet më i ulët se mesatarja e vendeve evropiane. Kjo mund të shpjegohet nga mbledhja intensive e drurëve si lëndë për ngrohje nga pyjet e Kosovës. Edhe përkundër kësaj, sasi e madhe e mbetjeve pyjore e shkaktuar nga prerjet ligjore, jo ligjore dhe dëmtimet e pyjeve nga faktorët abiotik, ngelet e pashfrytëzuar në pyje që shkakton prodhimin e sasive të mëdha të Karbonit (C), sëmundjeve, insekteve si dhe zjarreve pyjore. Largimi i mbetjeve pyjore dhe shfrytëzimi i tyre, do të ndikojë në prodhimin e energjisë ripërtëritëse, largimin gradual të karburanteve fosile, si dhe de-karbonizimin e ekonomisë në Kosovë, e gjithashtu dhe në përmbushjen e synimit të Komisionit të BE-së, për largimin e karbonit. Por, duhet të përdoret në mënyrë të qëndrueshme.

Gjithashtu, përqindja e madhe e mbulesës pyjore në Kosovë ndikon në absorbimin e sasive të mëdha të karbonit (C) dhe lirim të oksigjenit (O₂), që ndikojnë në masat parandaluese dhe zbutjen e ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe efektit serë (GGH). Një menaxhim shumë funksional dhe i qëndrueshëm i burimeve natyrore, do të përmirësojë kushtet tona të jetesës dhe mbetjes së një mjedisi të shëndetshëm, krijimin e vendeve të punës si dhe sigurimin e burimeve të qëndrueshme të energjisë.

Në Kosovë, dy masive pyjore janë shpallur parqe kombëtare nga qeveria: Sharri në jug të Kosovës dhe Bjeshkët e Nemuna, në perëndim të Kosovës. Të dyja parqet kombëtare ndodhen në sipërfaqe pyjore me lartësi të madhe mbidetare. Deri më tani vetëm Parku Kombëtar i Sharrit është përkufizuar dhe klasifikuar në zona, sipas objektivave menaxhuese. Shumica e pyjeve halore dhe të përziara halore (afro 90%), ndodhen brenda kufijve të parqeve kombëtare.

3.4 PRODHIMI PYJOR

Sipas rezultateve të IKP-së, prerja vjetore e qëndrueshme vlerësohet të jetë 1.45 milionë m³, me afro 630 000 m³ në pyje të cilësisë së lartë dhe 815 000 m³ në pyje cungishte të cilësisë së ulët. Megjithatë, aktualisht prerja vjetore e lëndës drunore arrin në 1.6 milionë m³, që është rreth për 1/4 më e lartë se niveli i rekomanduar dhe afatgjatë. Për më tepër, vetëm 10 – 15 % e vëllimit pyjor aktualisht pritet sipas rregulloreve ekzistuese, që do të thotë se MBPZHR-ja, – Agjencia Pyjore e Kosovës, e shfrytëzon afro 200 000 m³ në vit. Arsyet kryesore për këtë janë prerja e ilegale e pa ndalur dhe aktivitetet joformale në pyje, pronat e fragmentuara dhe të vogla të pyjeve private (një/dy hektarë mesatarisht), si dhe shkalla e ulët e zbatimit të planeve menaxhuese të pyjeve.

Megjithëse pyjet e Kosovës përfaqësojnë një burim të rëndësishëm të potencialit ekonomik, praktikat aktuale nuk sigurojnë të hyra të rëndësishme për ekonominë e vendit. Zbatimi i dobët i ligjit dhe qeverisja joefektive dhe joefikase, e çojnë në humbje të rendimentit ekonomik, që përndryshe do të kontribuonte në ekonominë lokale dhe do të përmirësonte jetesën e qëndrueshme. Gjithashtu, shfrytëzimi i parregulluar i burimeve pyjore çon në shpyllëzim, i cili ka pasoja negative serioze në mjedis dhe në ekonominë lokale e kombëtare.

Për shkak të pozitës së saj gjeografike, konfigurimit të relievit, përbërjes gjeologjike dhe pedologjike, si dhe kushteve klimatike, Kosova ka një florë të pasur me një numër të madh bimësh endemike dhe steno-endemike. Grykat e lumenjve, në veçanti, ofrojnë habitate për lloje relikte dhe relikte endemike. Në bazë të disa inventarëve sporadikë të bërë nga qarqet akademike, deri më tani janë identifikuar 84 lloje të rëndësishme komerciale me 29,000 tonë lëndë të parë të tharë.

PPJD-të, (frutat pyjore, kërpudhat dhe bimët mjekësore e aromatike), mund të jenë të një rëndësie të konsiderueshme ekonomike për popullsinë rurale. Në Kosovë, shfrytëzimi i këtyre llojeve produktesh dhe shërbimesh, nuk është shumë mirë i organizuar. Arsyja kryesore për këtë mangësi është zhvillimi i kufizuar i legjislacionit mbështetës.

Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të vlerësuar në mënyrë koncize kontributin e sektorit të pylltarisë në ekonominë kombëtare. Ndodh shpesh që të dhënat ekzistuese e nënçojnë këtë kontribut. Megjithëse për jetesën e banorëve të vendeve rurale janë tejet të rëndësishme aktivitetet joformale si grumbullimi i masës drunore si lëndë për ngrohje, të dhënat të cilat në rastin e Kosovës nuk kanë besueshmëri të mjaftueshme janë statistikat për punësimin, produktet me vlerë të shtuar dhe balanca furnizim-kërkesë e produkteve drusore nga pyjet publike dhe private, nuk mbahen në mënyrë sistematike.

Në bazë të studimeve dhe raporteve të shpërndara të projekteve të ndryshme, mundë të arrihet në përfundim, si në vijim:

Pylltaria në Kosovë aktualisht punëson vetëm afro 2% të gjithsej fuqisë punëtore. Punësimi formal dhe joformal në operacionet e shfrytëzimit të pyjeve sillet ndërmjet 2500-3000 vende pune. Institucionet qeveritare që ndërlidhen me pyjet punësojnë 288 persona, prej të cilëve 48 janë gra. Industria e përpunimit të drurit kontribuon në punësim me një përqindje më të lartë. Në Kosovë janë 1778 biznese të produkteve të drurit dhe mobilieri, të cilat kryesisht janë ndërmarrje mikro, me më pak se 10 të punësuar. Gjithsej të punësuarit në industrinë e drurit e vlerësohen të jenë rreth 5000-6000 punonjës. Numri i grumbulluesve të produkteve pyjore jo drun ore (PPJD), llogaritet të jetë ndërmjet 11,400-20,000 me rreth 100 kultivues, 30-40 qendra grumbulluese dhe 10 kompani përpunuese.

Kontributi i i pylltarisë në BPV është rreth 1% dhe vlera e prodhimit të lëndës drusore sillet ndërmjet 24-48 milionë €, ndërsa industria e përpunimit final të drurit, ndërmjet 40-50 milionë €. Nuk ka të dhëna zyrtare për PPJD-të.

Eksporti i produkteve drusore ishte gjithsej 28.6 milionë € më 2019, që përfaqëson 7.5% të gjithsej eksportit. Eksporti i PPJD-ve, llogaritet të jetë rreth 16.6 milionë €. Raporti eksport-import është 1:7, krahasuar me 1:29 në vitin 2012.

Gjithsej buxheti vjetor i ndarë për sektorin e pylltarisë ka qenë stabil në 5 vjetët e fundit, me 2.2 milionë €. Të hyrat nga sektori i pylltarisë kanë shënuar rritje të lehtë në periudhën e njëjtë, duke arritur në 1.9 milionë € në vitin 2019, që është më e lartë se gjithsej shpenzimet për 0.5 milion €.

3.5 POLITIKAT, LEGJISLACIONI DHE KORNIZA INSTITUCIONALE

POLITIKAT DHE STRATEGJITË

Qeveria e Kosovës e njih rëndësinë e pyjeve dhe të sektorit të përpunimit të drurit, si dhe thekson nevojën për sigurimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve, si një mundësi jetike për të siguruar furnizimin e qëndrueshëm me material drusor, që mund të përdoret për ngrohje dhe qëllime industriale. Qeveria nënvizon pasojat e rënda të dëmtimit, degradimit dhe shkretimit të pyjeve, tokave pyjore dhe biodiversitetit, duke theksuar gjithashtu rëndësinë e pyjeve në masat parandaluese dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Kosova është në proces të zhvillimit të Strategjisë së re Kombëtare për Zhvillim (SKZH). SKZH-ja, ekzistuese (2016-2021) ishte një qasje e re ndaj politikave zhvillimore. Ajo adresonte të gjithë faktorët që kufizonin rritjen ekonomike dhe standardin e jetesës. Strategjia, po ashtu nënvizonte domosdoshmërinë për integrimin e politikave dhe strategjive ekzistuese të sektorëve të ndryshëm. Kjo mund të çonte jo vetëm në veprime koherente, por edhe në identifikimin e prioriteteve të vendit. E bazuar në katër shtylla – kapitali njerëzor; sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë; zhvillimi i industrive konkurruese; dhe zhvillimi i infrastrukturës – SKZH-ja, e ngarkonte sektorin e pylltarisë që të siguronte shfrytëzimin e qëndrueshëm të pyjeve të Kosovës, si dhe të parandalonte degradimin e tyre.

Furnizimi i qëndrueshëm dhe i parashikueshëm me material drunor dhe produkte jo drunore, për industrinë e Kosovës, gjithashtu është adresuar sipas qasjes së ekosistemit. SKZH-ja, qartë tregonte që shpyllëzimi mund të sillte ndikime të rëndësishme negative ekonomike dhe shoqërore, përveç dëmtimit të ekosistemit. Kërkesa e lartë për material drunor, trysnia e shfrytëzimit, si dhe prerjet jo ligjore të pyjeve, janë theksuar si një ndër shkaqet kryesore të dëmtimit dhe degradimit, deri në shkretim të pyjeve. SKZH-ja, gjithashtu ka identifikuar mungesën e planeve të duhura të menaxhimit të pyjeve, si çështje shqetësuese. Gjithashtu, kapacitetet e pamjaftueshme të institucioneve të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve pyjore, janë identifikuar si pengesa kryesore.

Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2022-2030, përputhet me aktivitetet e planifikuara të SKZH-së, strategjitë zhvillimore dhe programet e ministrive të linjës, si dhe është në harmoni me kornizën ligjore evropiane dhe marrëveshjet ndërkombëtare, lidhur me menaxhimin shumë funksional të pyjeve.

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2020-2023, parasheh pyllëzimin e tokave pyjore të zhveshura, sipërfaqeve pyjore të dëmtuara dhe pyjeve të degraduara, si dhe kërkon masa parandaluese dhe ndryshime ligjore e institucionale, që mundësojnë shfrytëzimin racional të pyjeve dhe që i fuqizojnë kapacitetet e Agjencisë Pyjore të Kosovës.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH), i jep përparësi mbrojtjes së burimeve pyjore dhe thekson urgjencën e pyllëzimit në sipërfaqe të reja. KASH nënvizon që për qëllime mjedisore, ekonomike dhe shoqërore, duhet të krijohet një mjedis i përshtatshëm përmes rishikimit dhe ndryshimit të legjislacionit ekzistues për pylltarinë.

Gjithashtu, është përgatitur Programi Kombëtar i Pyllëzimit dhe Ripyllëzimit i Kosovës (PKPR) 2018-2027 dhe Programi Kombëtar i Shëndetit të Pyjeve (PKSHP) 2018-2027. PKPR-ja, synonte rritjen e pyjeve të Kosovës me 5%, mirëpo është vlerësuar si program tej ambicioz dhe vështirë i realizueshëm. Ndërkaq, PKSHP-ja, synonte përmirësimin e shëndetit të pyjeve, por zbatimi i të njëjtit ngelet sfidë për institucionet përgjegjëse të administrimit dhe menaxhimit të pyje, si shkak i mungesës së kapaciteteve njerëzore dhe mjeteve financiare.

Strategjia për Ndryshimet Klimatike (SNK) 2019-2028, thekson që nën barrën e rëndë të problemeve mjedisore të akumuluar gjatë dekadave, Kosova përpiqet ta ristrukturojë bujqësinë dhe sektorin e pylltarisë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, bazuar në standarde evropiane. Shfrytëzimi i burimeve natyrore, dendësia e lartë e popullsisë, ndërtimet e pakontrolluara në toka bujqësore, shfrytëzimi i pakontrolluar i pyjeve, prerjet ilegale, aktivitetet ekonomike dhe industriale, shfrytëzimi i minerareve (gurorëve) dhe industria përpunuese, janë shkaktarët kryesorë të degradimit mjedisor.

Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (PBZHR), është ndërtuar mbi 4 shtylla: konkurrueshmëria; mjedisi dhe përmirësimi i shfrytëzimit të tokës; diversifikimi rural, cilësia e jetës rurale dhe strategjitë e zhvillimit lokal, të bazuara në komunitet. Vizioni i përgjithshëm i tij ishte: “të kontribuoj në mënyrë të balancuar në mirëqenien ekonomike, mjedisore, shoqërore e kulturore të viseve rurale dhe të Kosovës në tërësi, përmes partneriteteve efektive dhe fitimprurëse ndërmjet sektorit privat, qeverisë qendrore/komunale dhe komuniteteve lokale brenda kontekstit evropian”. Përmirësimi të menaxhimit të burimeve natyrore i jepet përparësi e lartë. Në kuadër të Masës 5 të Kapitullit 4, zhvillimi i pylltarisë dhe pyllëzimi, përmenden si alternativa për shfrytëzimin e tokës bujqësore. Plani thotë që pylltaria është një aktivitet ekonomik i rëndësishëm në viset malore dhe mund të ofrojë mundësi të punësimit afatgjatë. Pylltaria private theksohet si e nën zhvilluar. PBZHR-ja, mbështet shfrytëzimin e qëndrueshëm të funksioneve ekonomike, mjedisore dhe shoqërore të pyjeve. Theks i veçantë i vihet në plan pyllëzimit të tokave bujqësore të braktisura dhe jo pjellore për kultura bujqësore. PBZHR-ja, gjithashtu zotohet të ndihmojë pyllëzimin dhe sistemet e agro-pylltarisë, veçanërisht në zonat e *Natura 2000*.

Plani Kombëtar i Veprimit për Energjinë e Ripërtërishme (PKVER, 2011-2020), i referohej Strategjisë për Zhvillimin e Pylltarisë (SZHP, 2010-2020) kur thotë që, veçanërisht në viset rurale, druri mbetet burimi më i rëndësishëm i energjisë për ngrohje. Strategjia përcakton masa të veçanta për promovimin e përdorimit të energjisë nga biomasa. Ajo vlerëson që 120 GWh energji mund të prodhohen në vit nga biomasa (mbetjet pyjore), duke shprehur njëkohësisht shqetësimin që realizimi i projekteve të këtilla pengohet, para së gjithash, për shkak të kostos.

LEGJISLACIONI

Aktivitetet e pylltarisë realizohen sipas Ligjit nr. 2003/3 për Pyjet (14.10.2004), ndërsa Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, është në proces të hartimit të një ligji të ri për pyjet. Ekzistojnë 45 akte nënligjore (udhëzime administrative) që lidhen me pylltarinë dhe gjuetinë, e disa prej tyre janë ndryshuar dhe plotësuar një ose dy herë. Përveç Kushtetutës dhe Ligjit për Pyjet, janë rreth 13 ligje që ndërlidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me pyjet.

Në bazë të rezultateve të anketës së realizuar në kuadër të studimit mbi vendosjen e pikënisjeve dhe treguesve për ligjshmërisë e shfrytëzimit të pyjeve, shumica e institucioneve mendojnë se Ligji për Pyjet nuk është mjaft i qartë dhe duhet të ndryshohet. Gjatë diskutimeve, vëmendje e veçantë i kushtohet ndarjes së përgjegjësive dhe mandateve ndërmjet autoriteteve lokale (komunave) dhe institucioneve të nivelit qendror. Mendohet gjithashtu se Ligji për Pyjet, është në konflikt me shumë ligje të tjera dhe udhëzime administrative. Rrjedhimisht, Ligji për Pyjet ka mundur të zbatohet vetëm pjesërisht.

Kosova ka bërë përpjekje të rëndësishme gjatë viteve të kaluara për të marrë pjesë në nismat dhe konventat rajonale dhe ndërkombëtare në lidhje me biodiversitetin dhe ruajtjen e mjedisit, por ky proces është ngarkuar vazhdimisht me probleme politike. Kosova është bërë vend anëtar bashkëpunues i Agjencisë Evropiane të Mjedisit (EEA), së bashku me pesë ekonomitë e tjera të EJT-së, të cilat nuk janë anëtare të BE-së. Për arsye politike, Kosova ende nuk ka ratifikuar asnjërin nga marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e biodiversitetit dhe/ose mjedisit.

INSTITUCIONET

Agjencia Pyjore e Kosovës (APK) në kuadër të MBPZHR-së, është përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e pyjeve dhe tokave pyjore publike, si dhe kontrollimin e menaxhimit të pyjeve dhe tokave pyjore private, përfshirë grumbullimin e produkteve pyjore jo drunore. Bazuar në Ligjin për Gjuetinë, APK-ja, është gjithashtu pjesërisht përgjegjëse për gjuetinë dhe menaxhimin e kafshëve të egra. Departamenti i Pylltarisë në kuadër të MBPZHR-së, është përgjegjës për politikën dhe strategjitë e sektorit të pylltarisë. MMPHI, nëpërmjet Drejtorisë së Parkut Kombëtar "Sharri" dhe Drejtorisë së Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", është përgjegjëse për menaxhimin e dy parqeve kombëtare në Kosovë. Ato gjithashtu mbledhin në mënyrë sporadike informata mbi biodiversitetin dhe ekosistemin në terren. Inspektorati për Mbrojtjen e Mjedisit është përgjegjës për inspektimin e mbrojtjes së natyrës, ndërsa Inspektorati i Pylltarisë dhe Gjuetisë në kuadër të APK-së, monitoron menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, menaxhimin e kafshëve të egra dhe grumbullimin e produkteve pyjore jo drunore.

Sipas raportit të Ministrisë së Financave, numri i përgjithshëm i personelit që punon në sektorin e pylltarisë është 162 (155 në APK dhe 7 në DP në kuadër të MBPZHR-së), ndërsa numri i personelit që punon në nivel komunal është 194. Disa komunave u mungon stafi në këtë sektor. Sa i përket trajnimit të stafit, është raportuar se nuk janë mbajtur trajnime të mjaftueshme gjatë 5 viteve të fundit, ku vetëm 3 komuna kanë deklaruar se kanë mbajtur shumë pak trajnime. Asociacioni Kombëtar i Pronarëve të Pyjeve Privatë (AKPPPK), organizoi 12 trajnime për shfrytëzimin e pyjeve dhe 146 për tema të tjera.

Komunat kanë kapacitete të kufizuara të stafit të pylltarisë (4 inxhinierë?, 35 teknikë, 205 roje pyjore). Pagat dekurajuese, kushtet e këqija të punës si dhe mungesa e pajisjeve dhe automjeteve, janë ndër problemet që pengojnë aktivitetet pyjore në terren.

Përkufizimi ligjor i pyjeve si një resurs kombëtar me interes të përgjithshëm, dikton bashkëpunimin dhe koordinimin e shumë palëve të interesit, institucioneve të qeverisë qendrore dhe atyre komunale, si dhe shoqatave joqeveritare.

Palët kryesore të interesit janë:

INSTITUCIONET QEVERTARE

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), (Agjencia Pyjore e Kosovës (APK) – Departamenti i Pylltarisë (DP)
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)
- Ministria e Industrisë , Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT)
- Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)
- Komunat.

INSTITUCIONET JOQEVERTARE

- Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës (SHPKD)
- Asociacioni Kombëtar i Pronarëve të Pyjeve Private (AKPPP)
- Oda Ekonomike e Kosovës (OEK).

SWOT ANALIZA

SWOT analiza e sektorit të pylltarisë në Kosovë, tregon qartë përmasat e problemeve dhe sfidave aktuale. Kapaciteti institucional është më i theksuari në lidhje me aspektet teknike dhe financiare. Kuadri ligjor ekzistues dhe organizimi institucional, janë ndër pikat e forta të sektorit, edhe pse kuadri ligjor u konsiderua i dobët për disa fusha të caktuara. Një nga çështjet më me rëndësi, janë praktikatat aktuale të përdorimit të drurit, që sjellin humbje të mëdha ekonomike. Sipas analizës, nëse sigurohen kushtet e prodhimit të qëndrueshëm të drurit, sigurisht që do të ndryshojë edhe gjendja për të mirën e ekonomisë kombëtare.

PËRPARËSITË	DOBËSITË
<ul style="list-style-type: none"> • Rëndësia strategjike e pyjeve (resurse kombëtare) • Ekzistimi i kornizës strategjike & ligjore, si dhe i strukturave administrative e menaxhuese • Programi kombëtar për pyllëzime dhe ripyllëzime 2018-2027 dhe • Programi kombëtar për shëndetin pyjor • Biodiversiteti i pasur • Ekzistimi i Institutit të Pylltarisë në Pejë • Përqindja e volitshme e tokës pyjore në pronësi private • Pyjet në parqet kombëtare, përfaqësojnë zona të jashtëzakonshme me rëndësi për zhvillimin dhe përmirësimin e aktiviteteve kërkimore shkencore • Fillimi i përdorimit të biomasës së drurit si energji e rinovueshme 	<ul style="list-style-type: none"> • Sasi e madhe e drurit teknik përdoret për dru zjarri • Mungesa e profesionistëve të rinj dhe stafit të motivuar në Administratën Pyjore, si dhe kompanitë për shkak të pagave jo-stimuluese dhe numri i vogël i studentëve të pylltarisë • Mungesa e mbështetjes publike dhe politike ndaj sektorit të pylltarisë • Buxhet i vogël (modest) për tërë sektorin • Ndarja (shpërndarja) e kompetencave karshi mundësive profesionale ekzistuese • Rezultat jo i kënaqshëm i mbijetesës së fidanëve të pyllëzuar • Kornizë e dobët ligjore për dhënien e tokave pyjore me qira dhe ndërrimin e destinimit • Infrastrukturë e dobët pyjore dhe mungesë e mirëmbajtjes • Kapacitete të limituara të sektorit privat për ofrimin e shërbimeve profesionale në pylltari • Mos përfshirja e sektorit të pylltarisë në masat mbështetëse – (subvencione & granate, masa 202 ngritja dhe mbrojtja e pyjeve përmes IPARD) • Mos themelimi i fondit për ripërtëritje të pyjeve

	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e inventarizimit për kafshë të egra si dhe përditësimi i inventarizimit për bimët mjekuese dhe aromatike • Fonde të pamjaftueshme për edukim dhe hulumtim të çështjeve mjedisore • Mungesa e moduleve për pylltari në Qendrat Trajnuese Rajonale, në kuadër të Agjencisë së Punësimit. • Mos funksionalizimi i laboratorit në institut (mungesa e kuadrit profesional për hulumtime aplikative në pylltari). • Shfrytëzimi i pyjeve vetëm me kontrata afatshkurtra njëvjeçare përmes tenderimit, mos zbatimi i koncesioneve dhe formave të tjera të shfrytëzimit afatgjatë dhe të qëndrueshëm të pyjeve • Mungesa e kadastrës pyjore • Mungesa e shërbimeve këshillimore për pronarët e pyjeve private në pylltari • Mungesa e koordinimit ndërinstitucional për menaxhimin e pyjeve në Parqet Kombëtare
MUNDËSITË	RREZIQET
<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e vlerës ekonomike, sociale dhe mjedisore, me rastin e menaxhimit shumë funksional të pyjeve • Rritja e mundësive të punësimit • Shtimi i pjesëmarrjes në BPV/GDP • Sigurimi i materialit riprodhues, farërave dhe fidanëve nga pyjet me origjinë autoktone • Shtimi/rritja e prerjeve të rregullta ligjore me synim plotësimin e nevojave të popullatës lokale • Zhvillimi i zonave rurale me rastin e aplikimit të përdorimit shumë qëllimor të resurseve pyjore • Zgjerimi i sipërfaqeve pyjore përmes pyllëzimeve • Përmirësimi i gjendjes në pyjet e degraduara (ripyllëzimi) • Shfrytëzimi i biomasës drunore për prodhim të energjisë ripërtëritëse • Shtimi i potencialit prodhues të pyjeve • Certifikimi i pyjeve sipas standardeve ndërkombëtare • Ngritja e efikasitetit dhe profesionalizmit në menaxhimin e pyjeve, përmes reformimit të institucioneve përgjegjëse për menaxhim dhe administrim • Ngritja e kapaciteteve të sektorit privat (licencimi dhe standardizimi) • Zhvillimi/fuqizimi i partneritetit publiko-privat • Organizimi i tregjeve legale të drurit dhe produkteve të tij • Krijimi i departamentit për ofrimin e shërbimeve në pyje private • Inkurajimi i grave për t'u bërë pjesë e strukturave organizative pyjore përmes konkurseve të ndjeshme gjinore (duke përfshirë zbatimin e masave afirmative) • Përditësimi i caktimit të taksave pyjore për shfrytëzimin e tokave pyjore dhe kompensimit të dëmeve 	<ul style="list-style-type: none"> • Dëmtimi i vazhdueshëm i pyjeve nga prerjet jo ligjore, faktorët biotikë dhe abiotikë • Aplikimi i llojit të prerjeve jo profesionale sipas tipave të pyjeve • Ndikimi i ndryshimeve klimatike • Dëmtimi i tokave pyjore, peizazhit, shkaktimi i erozionit • Ndotja e ajrit, burimeve ujore dhe rrjedhave ujore • Ndotja e ekosistemeve pyjore nga hedhja e mbeturinave • Uzurpimet e pyjeve dhe tokave pyjore • Vazhdimi i përdorimit/shfrytëzimit të pyjeve private pa PM • Dominimi i qasjes së konservimit dhe mos respektimi i nevojave të komunitetit rreth dhe brenda territorit të parqeve • Futja e llojeve invazive • Humbja e bazës gjenetike përmes blerjes së farërave jashtë vendit • Dëmtimi i pyjeve nga faktorët biotikë dhe abiotikë • Pamjaftueshmëria buxhetore për të zbatuar projektet zhvillimore të sektorit • Mungesa e kontrollit dhe monitorimit të mjaftueshëm nga mbi shfrytëzimi, duke rrezikuar zhdukjen e llojeve të caktuara • Degradimi i mjedisit dhe zonave pyjore • Migrimi i të rinjve nga zonat rurale • Paragjykimi se puna pyjore është punë e burrave dhe pamundësi e grave për t'u përfshirë • Uzurpimet e tokave pyjore dhe ndërrimi i destinimit të tokave pyjore • Paraqitja e zjarreve pyjore, mungesa e marrjes së masave meliorative

4. SYNIMET DHE OBJEKTIVAT

DEKLARATA POLITIKE

Të vetëdijshëm për sfidat e vazhdueshme mjedisore globale në aspektin e ndryshimeve klimatike, humbjes së diversitetit dhe degradimit të tokës, që menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve luan rol thelbësor në adresimin e këtyre sfidave.

Duke rikujtuar që në përputhje me Instrumentin Ligjërësht Jodetyrimor mbi Pylltarinë dhe Planin Strategjik për Pylltarinë të OKB-së, Strategjia për Sektorin e Pylltarisë në Kosovë, gjithashtu do të kontribuojë në arritjen e caqeve të Synimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Duke pasur parasysh që Strategjia e BE-së, për Pylltari e nxjerrë në vitin 2021, do të maksimizojë kontributin e pylltarisë drejt arritjes së një Evrope neutrale ndaj karbonit.

Duke njohur rëndësinë e pyjeve dhe të sektorit të përpunimit të drurit, si dhe nevojën për të siguruar menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, si një mundësi themelore për sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me material drusor për ngrohje dhe qëllime industriale.

Duke ditur gjithashtu që pyjet në Kosovë kanë potencial për të kontribuar në masë të madhe në mirëqenien e banorëve rural, përmes ofrimit të punësimit dhe aktiviteteve për gjenerimin e të ardhurave.

Duke qenë në dijeni të rëndësisë së mbrojtjes së pyjeve për një ekosistem të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm.

Duke ditur që potenciali i burimeve pyjore nuk shfrytëzohet plotësisht për shkak të disponueshmërisë së kufizuar të teknologjisë së duhur dhe të personelit të trajnuar, dobësive të strukturave organizative dhe të zbatimit të legjislacionit, lidhur me mbrojtjen dhe menaxhimin e burimeve pyjore.

Duke shprehur shqetësimin që pyjet private janë tejet të fragmentuara për t'u shfrytëzuar në mënyrë efikase dhe që çështja e ndërmarrjeve të vjetra në pronësi shtetërore ende nuk është zgjidhur.

Duke kujtuar se Korniza Ligjore dhe modelet e qeverisjes aktuale, duhet të përfshijnë aktivitetet e propozuara të Strategjisë, kështu që reformat në fusha të caktuara janë të nevojshme.

Duke ripohuar që Plani i Veprimit i Strategjisë ka natyrë dinamike dhe do të rishikohet dhe ripërtërihet çdo tre vjet, për të ofruar fushëveprim më të gjerë bazuar në kapacitetet e zhvilluara dhe në rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të saj.

PARIMET

Zbatimi i Strategjisë për Sektorin e Pylltarisë në Kosovë do të jetë në harmoni dhe në përputhje me objektivat zhvillimore, politikat, strategjitë dhe legjislacionin kombëtar. Ajo do të zbatohet sipas parimeve të fuqizimit të bashkëpunimit ndër-sektorial, sigurimit të pjesëmarrjes së palëve të interesit, ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe tradicionale, si dhe harmonizimit me zotimet ndërkombëtare mbi pylltarinë.

ÇËSHTJET GJINORE

Strategjia do të përqendrohet në inkurajimin e barazisë gjinore, ku qëllimi kryesor është që të ofrohen mundësi të barabarta për gratë dhe burrat në aktivitetet që kanë të bëjnë me mundësimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe sanimin e peizazheve të degraduara të Kosovës. Kjo e bën të domosdoshme pjesëmarrjen e plotë të grave në të gjitha nivelet e hartimit dhe zbatimit të politikave për ruajtjen dhe ripërtëritjen e ekosistemit.

OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM (OZHQ)

Kjo SZHP do të sigurojë një kornizë të kontributeve të ndërlidhura me pyjet drejt zbatimit të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe për arritjen e shumicës së synimeve të zhvillimit të qëndrueshëm (SDGs). SZHP-ja, synon që të kontribuojë në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve pyjore në vend, nëpërmjet forcimit të mjedisit të favorshëm për sektorin e pylltarisë, prezantimit të planifikimit të menaxhimit të pyjeve me shumë qëllime, restaurimit të tokave pyjore të degraduara dhe masave për mbrojtjen e pyjeve. Këto objektiva do të kenë kontribut të drejtpërdrejtë në SDG 15-Jeta në tokë (15.2 "Deri në vitin 2020, të promovojë zbatimin e menaxhimit të qëndrueshëm të të gjitha llojeve të pyjeve, të ndalojë shpyllëzimin, të rivendosë pyjet e degraduara dhe të rrisë ndjeshëm Pyllëzimin dhe Ripyllëzimin (P/R) globalisht") dhe gjithashtu për qëllime të tjera thelbësore; 6-Ujë të pastër dhe kanalizime, 7-Energji e përbalueshme dhe të pastër, 8-Punë e denjë dhe rritje ekonomike, 12-Konsum dhe prodhim i përgjegjshëm, 13-Veprim klimatik. SZHP-ja, është gjithashtu mbështetëse në SDG; 1-Jo varfëri, 4-Arsim cilësor, 5-Barazi gjinore, 9-Industria, inovacioni dhe infrastruktura dhe 11-Qytete dhe komunitete të qëndrueshme.

SYNIMI I PËRGJITHSHËM

Synimi i përgjithshëm i kësaj strategjie është ruajtja, shtimi i vlerës dhe potencialit të resurseve pyjore, me objektiv që të rritet kontributi i tyre në ekonominë kombëtare, gjithmonë përmes aplikimit të menaxhimit të qëndrueshëm dhe shumë funksional të pyjeve.

Për të arritur këtë synim, prioritetet që duhet ndërmarrë janë këto:

- Parandalimi i prerjeve të paligjshme
- Mbrojtja e pyjeve dhe tokave pyjore nga ndërhyrjet tjera të paligjshme
- Mbrojtja e shëndetit dhe vitalitetit të pyjeve nga faktorët biotikë dhe abiotikë
- Rritja e sipërfaqes pyjore nëpërmjet pyllëzimeve, ripyllëzimeve dhe ripërtëritjes natyrore, përfshirë edhe pyllëzimin e tokave të degraduara, tokave të braktisura dhe ripyllëzimin e pyjeve të degraduara
- Rritja e vlerës dhe produktivitetit të pyjeve përmes përdorimit shumëqëllimor të potencialit të përgjithshëm të prodhimit të masës drunore, produkteve pyjore jo drunore si dhe funksioneve dhe aspekteve tjera pyjore
- Përmirësimi i strukturave organizative dhe ngritja e kapaciteteve të resurseve humane për qeverisje transparente dhe menaxhim shumëqëllimor të pyjeve
- Digjitalizimi i të dhënave pyjore dhe funksionalizimi i Sistemit Informativ për Pyjet e Kosovës
- Shtimi dhe ruajtja e cilësisë dhe dendësisë optimale të rrugëve pyjore, si dhe infrastrukturës ndihmëse
- Avancimi dhe përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional, rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe anëtarësimi në rrjetet dhe organizatat relevante
- Përfshirja e pylltarisë në skemat qeveritare të mbështetjes dhe zhvillimi i bashkëpunimit me institucionet financiare dhe publikun e gjerë
- Inkurajimi i zhvillimit të shoqatave të pronarëve të pyjeve private, përpunuesve, grumbulluesve dhe përdoruesve, në mënyrë që të forcohet kapaciteti i tyre për zbatimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve. Për arritjen e synimit të përgjithshëm të politikave, janë identifikuar 5 objektiva strategjike për dhjetë vjetët e ardhshme:

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: PËRMIRËSIMI I GJENDJES SË RESURSEVE PYJORE

Resurset pyjore do të mirëmbahen dhe shtohen për të kontribuar në zhvillimin mjedisor, ekonomik dhe shoqëror të Kosovës.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.1: RISHIKIMI DHE PËRDITËSIMI I KORNIZËS LIGJORE PËR PYLLTARINË

Zbatimi i pamjaftueshëm i ligjeve, akteve nënligjore, strategjive dhe programeve, është kryesisht pasojë e mbivendosjeve të juridiksionit dhe konfliktit në raste të caktuara. Përveç kësaj, ekziston një boshllëk në legjislacion për çështjet që lidhen me pylltarinë, të tilla si statusi i ish ndërmarrjeve shoqërore pyjore, konsolidimi i tokës pyjore dhe kategorizimi i peizazhit pyjor. Prandaj, ekziston një nevojë urgjente për të përmirësuar kornizën ligjore të pylltarisë. Ligjet dhe aktet nënligjore të shëndosha dhe të qëndrueshme, do të ndihmojnë në përmirësimin e zgjidhjeve të problemeve të menaxhimit të pyjeve dhe mbrojtjes së burimeve pyjore.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.2: PYJET PUBLIKE ADMINISTROHEN ME PLANE MENAXHUESE AFATGJATË

Duke pasur parasysh ndërlikimin e resurseve pyjore me shumë procese biologjike ndërvepruese, plani i menaxhimit të pyjeve është jetik për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, duke balancuar dhe ruajtur funksionet ekonomike, ekologjike dhe shoqërore. Për shumicën e pyjeve të Evropës ka plane menaxhuese të modaliteteve të ndryshme. Zhvillimet e reja teknologjike ofrojnë mundësi të reja për plane menaxhuese, më gjithëpërfshirëse. Qasja e re e bazuar në ekosistem, parasheh plane menaxhuese të integruara shumëqëllimore, ku shumë klasa menaxhuese për qëllime të caktuara, planifikohen si module të ndërlidhura. Pasi në Kosovë mbizotërojnë pyjet cungishte, duhet përqendruar në plane menaxhuese më të thjeshtuara për pyjet e ulëta publike dhe private. Procesi i planifikimit të menaxhimit do të paraprihet me konsultime me palët lokale të interesit lokal, të cilat do të lehtësojnë planifikimin me pjesëmarrje të burimeve pyjore. Kosova gjithashtu duhet të zhvillojë dhe të testojë plane të integruara për menaxhimin e pyjeve në disa pika pilotuese, që do ta trasojnë rrugën për sistemin e ardhshëm të planifikimit të menaxhimit të pyjeve.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.3: TË DHËNAT PËR RESURSE PYJORE TË PËRDITËSUARA DHE NË DISPOZICION

Inventarizimi kombëtar i pyjeve është i nevojshëm për shumë arsye. Ofrimi i informatave të sakta rreth sipërfaqes, shpërndarjes, përbërjes dhe gjendjes së pyjeve, si dhe rreth trendit të tyre gjatë kohës, u ndihmon politikë – bërësve, në zhvillimin dhe monitorimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve. Inventari kombëtar i pyjeve, gjithashtu është një bazë e rëndësishme informatash për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare raportuese të Kosovës. Inventari kombëtar i fundit i pyjeve, i kryer në vitin 2012/2013 në Kosovë, duhet të përditësohet në vitin 2022.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.4: VENDOSJA E BAZËS SË KADASTRËS SË TOKAVE PYJORE

Shumë konflikte pronësore dhe problemet me kadastrën, e pengojnë menaxhimin e duhur të burimeve pyjore. Gjithashtu, ka pengesa në proceset e konsolidimit të tokave pyjore. Qartësimi i çështjeve që ndërlidhen me pronësinë dhe përcaktimi i kufijve të pyjeve, varet nga efikasiteti i punës kadastrale në kontekstin ligjor aktual. Strategjia synon të zvogëlojë problemet kadastrale të tokave deri në atë pikë që të mos ndikojnë konsiderueshëm në menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve. periudhën 2022-2030. Qëllimi është që të kompletohet kadastra e pyjeve në tërë Kosovën.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.5: HARTËZIMI I PYJEVE SIPAS FUNKSIONEVE

Pyjet i kanë tri funksione kryesore: ekonomike, ekologjike dhe shoqërore. Planet menaxhuese të pyjeve pritet t'i identifikojnë funksionet kryesore të njësive të planifikimit dhe të parashohin trajtimet e përshtatshme silvikulturore për to. Kjo nuk është një detyrë e lehtë për ekipet e menaxhimit të pyjeve

që punojnë me metoda tradicionale të marrjes së mostrave. Ata duhet të pajisen me harta, të cilat tregojnë shtresat e shumëfishta të veçorive që ndërlidhen me këto funksione. Informatat në lidhje me biodiversitetin janë të një rëndësie të veçantë. Zonat kryesore të biodiversitetit, zonat e mbrojtura, zonat buferike, korridoret ekologjike, zonat potenciale me produkte jodrusore, zonat potenciale rekreative, zonat e rrezikuara nga zjarri dhe shumë veçori të tjera, do t'u ndihmojnë planifikuesve për përgatitjen e një plani menaxhues më gjithëpërfshirës për pyjet, për të përfituar nga funksionet ekonomike, ekologjike dhe shoqërore të pyjeve, në mënyrë të qëndrueshme.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.6: SHITIMI I SIPËRFAQEVE PYJORE

Shkalla e mbulimit me pyje në Kosovë është 44.7%, që është më e lartë se mesatarja botërore (31%). Megjithatë, sipërfaqja pyjore për kokë banori në Kosovë (0.28 ha) është më e ulët se mesatarja botërore (0.6 ha) dhe shumë më e ulët se sa mesatarja e Evropës (rreth 1.4 ha). Duke pasur parasysh kushtet klimatike dhe gjeografike, ka potencial për rritjen e sipërfaqes pyjore në Kosovë, ku për periudhën dhjetëvjeçare synohet rritje prej 3%.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.7: RRRITJA E PRODHIMITARISË SË FARËRAVE DHE FIDANËVE PYJOR

Aktivitetet e pyllëzimit dhe rryllëzimit varen në masë të madhe nga disponueshmëria e farërave dhe fidanëve të përshtatur në kushtet lokale. Fidanishtja në Pejë prodhon fidanë, si dhe janë të identifikuar 8 grumbuj farorë, nga të cilët duhet të merren farërat. Prodhimi i përgjithshëm është tejet i kufizuar për të plotësuar kërkesën e pyllëzimit dhe rryllëzimit të programuar. Është me rëndësi që të rritet kapaciteti prodhues përmes modernizimit të fidanishteve dhe zhvillimit të kapaciteteve teknike, në mënyrë që realizohet siç duhet procesi nga grumbullimi i farërave deri tek mbjellja e fidanëve.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.8: PËRMIRËSIMI I PYJEVE ME ANË TE MASAVE SILVIKULTURORE

Pjesë të konsiderueshme të pyjeve të Kosovës janë dëmtuar si pasojë e praktikave të pakontrolluara dhe jo të qëndrueshme. Kapacitetet e kufizuara teknike dhe njerëzore janë pengesë për sanimin e peizazheve pyjore të degraduara. Për më tepër, me zhvillimin e konceptit të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve zhvillohen edhe teknikat silvikulturore. Silvikultura bashkëkohore e pyjeve shkon përtej rigjenerimit të thjeshtë, rrallimit, rehabilitimit, prerjes dhe mbjelljes, deri në atë pikë sa përfshin shumë teknika të zhvilluara rishtazi. Strategjia duhet të përfshijë aktivitete për zhvillimin e kapaciteteve që do t'i mundësonin APK-së, të zbatonte masat e duhura të silvikulturës në pyje.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: MBROJTJA E RESURSEVE PYJORE

Resurset pyjore do të mbrohen nga faktorët biotikë dhe abiotikë, do të mbrohet biodiversiteti dhe do të ruhen funksionet mbrojtëse të pyjeve.

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.1: ZVOGËLIMI I NDËRHYRJEVE JOLIGJORE NË PYJE

Siç është theksuar disa herë në këtë dokument, ndërhyrjet ilegale në pyje dhe toka pyjore, janë problemi më shqetësues në Kosovë. Burimet pyjore duhet të mbrohen për të ofruar material drunorë, produkte jo drunore dhe shërbime të qëndrueshme për mirëqenien kombëtare të vendit. Prandaj, nevojitet një qasje programore për ta adresuar këtë problem. Veprimet kundër prerjes ilegale nuk duhet të kufizohen vetëm në sferën e sundimit të ligjit. Ato duhet të plotësohen me zhvillim rural, eliminim të varfërisë dhe me programe për mirëqenie shoqërore. Ndërgjegjësimi është gjithashtu pjesë thelbësore e strategjisë dhe do të ndikojë në minimizimin e pasojave negative të ndërhyrjeve ilegale. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet parandalimit të prerjeve të paligjshme. Kapaciteti teknik

dhe institucional i organizatës për mbrojtjen e pyjeve do të rritet dhe do të përdoren teknologjitë e reja të mbikëqyrjes së pyjeve.

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.2: KONSOLIDIMI I TOKAVE PYJORE TË FRAGMENTUARA

Toka pyjore është tejet e fragmentuar në Kosovë. Kjo është para së gjithash pasojë e sipërfaqeve të vogla të pyjeve private. Sipas të dhënave të ofruara nga Asociacioni Kombëtar i Pronarëve të Pyjeve Private të Kosovës (AKPPPK), janë 132000 pronarë të pyjeve private, me madhësi mesatare të ngastrave pyjore prej 1.4 ha. Fragmentimi i këtij niveli e bën të vështirë menaxhimin ekonomik të pyjeve, prandaj shumë prej tyre mbeten pa kujdes. Nga ana tjetër, konsolidimi i tokave pyjore është një çështje ligjore e ndërlikuar me progres jo të kënaqshëm. Nevojitet rishikimi i kornizës ligjore ekzistuese lidhur me konsolidimin e tokës, si dhe përgatitja e një projektligji për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Ky projektligj duhet të marrë parasysh studimet në vazhdim e sipër me projektligjin për pyjet, i cili ofron një mundësi për zbutjen e problemit.

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.3: MONITORIMI DHE MBROJTJA E SHËNDETIT TË PYJEVE

Dëmtuesit dhe sëmundjet e pyjeve, janë kërcënim i zakonshëm ndaj burimeve pyjore. Vlerësohet që ndryshimet klimatike do ta përkeqësojnë gjendjen gradualisht. Nuk ka qenë e mundur të identifikohet saktë dëmi që vjen nga dëmtuesit dhe sëmundjet në pyjet e Kosovës. Rrjedhimisht, është e nevojshme të zhvillohen kapacitetet për monitorimin e burimeve (resurseve) pyjore dhe pengimin e shpërthimeve të insekteve, sëmundjeve dhe rreziqeve të tjera shëndetësore, që mund të çonin në humbje të mëdha të vlerës ekonomike dhe kërcënim të shëndetit dhe vitalitetit të pyjeve

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.4: RUAJTJA E BIODIVERSITETIT NË PYJET PRODHUESE

Rreth 70% e biodiversitetit tokësor zhvillohet në pyje. Përpyjekja globale për mbrojtjen e biodiversitetit vetëm në zonat e mbrojtura, nuk është zgjidhje përfundimtare ndaj humbjes së biodiversitetit. Ka pajtim të gjerë që biodiversiteti, gjithashtu duhet të ruhet në peizazhet prodhuese pa sakrifikuar prodhimin e drurit dhe produktet pyjore jo drunore, që janë jetike për ekonominë kombëtare dhe lokale. Zbatime të tilla si prerjet me ndikim të zvogëluar (PNZ) dhe mirëmbajtja, duhet të aplikohen në pyjet e Kosovës.

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.5: MBROJTJA E PYJEVE NGA ZJARRET

Shifrat e fundit tregojnë se sipërfaqja vjetore e dëmtuar nga zjarret pyjore është rreth 2.000 ha në Kosovë, prandaj aktivitetet për parandalimin e zjarreve pyjorë duhet të merren parasysh seriozisht. Përparimet e fundit në teknologji mundësojnë monitorimin e pyjeve dhe vendosjen e sistemeve të paralajmërimit të hershëm me kosto të përballueshme. Programet e ndërgjegjësimit janë gjithashtu efektive në parandalimin e zjarreve pyjore. Nga ana tjetër, duhet të fuqizohen kapacitetet e reagimit ndaj zjarrit, si dhe të përmirësohet sistemi i komunikimit dhe komandimit, me qëllim të ndaljes efektive të shpërthimeve të zjarrit.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: PËRDORIMI I QËNDRUESHËM DHE SHUMËQËLLIMOR I RESURSEVE PYJORE

Pyjet do të menaxhohen për të siguruar produkte të qëndrueshme drunore dhe jo drunore për të kontribuar në aspektet e përgjithshme socio-ekonomike të vendit.

OBJEKTIVI SPECIFIK 3.1 SHTIMI I PRERJEVE TË RREGULLTA NË PYJE

Kërkesa për material drunor po rritet vazhdimisht. Sektori i energjisë ripërtëritëse dhe industria e përpunimit të drurit, po zhvillohen veçanërisht në Kosovë. Nga ana tjetër, banorët rural përdorin lëndën e drurit për ngrohje, gatim dhe nevoja tjera familjare. Për të përmbushur këtë kërkesë në rritje, rrallimi para-komercial dhe komercial, duhet të bëhet siç duhet në pyjet cungishte të lëna pas dore. Pyjet e reja në Kosovë janë të një rëndësie të veçantë sa i përket potencialit për energji ripërtëritëse. Shtimi i prerjeve ligjore në pyje do të ngadalësojë prerjet ilegale dhe do ta shtojë rritjen vjetore të pyjeve. Metodatat e trajtimit duhet të avancohen dhe procedurat e prerjes në pyjet cungishte duhet të thjeshtohen. Prerjet vjetore të pyjeve nuk duhet të tejkalojnë 70% të shtimit vjetor të vëllimit të përgjithshëm të tyre.

OBJEKTIVI SPECIFIK 3.2: PËRKUFIZIMI DHE ZBATIMI I KRITEREVE DHE TREGUESVE TË MENAXHIMIT TË QËNDRUESHËM TË PYJEVE (MQP)

Përkufizimi, zbatimi i kriterëve dhe treguesve, përmbajnë bazën e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve të pajisur me prioritet dhe objektiva të qarta për të përmirësuar monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e aspekteve kryesore në pylltari. Në përpjekje për t'u integruar në pylltarinë evropiane, Kosova ndjek parimet dhe standardet e procesit të *Forest Europe*, në kuadër të të cilit janë përcaktuar 6 kritere dhe 34 tregues sasior dhe 11 tregues cilësor për Evropën. Bazuar në këto kritere dhe tregues MQP rajonalë, nga vendet pritet që të zhvillojnë grupin e tyre kombëtar të kriterëve dhe treguesve.

Kosova do të përcaktojë kritere dhe tregues që i përshtaten vendit dhe janë të zbatueshëm, me angazhim të gjerë të palëve të interesit me qëllim të krijimit të një kornize për të cilën pajtohen të gjithë, e cila do të shërbejë për monitorimin dhe vlerësimin e gjendjes dhe trendëve të pyjeve dhe pylltarisë. Përkufizimi, zbatimi i kriterëve dhe treguesve MQP, do të udhëheqë reformat e sektorit pyjor për të shfrytëzuar potencialin e plotë të pyjeve.

OBJEKTIVI SPECIFIK 3.3 SHFRYTËZIMI I QËNDRUESHËM I PPJD

Produktet pyjore jo drunore, po fitojnë rëndësi për sa i përket vlerës dhe ato janë jetike për jetesën e komuniteteve lokale. Nuk ekziston ndonjë inventar i gjerë i produkteve pyjore jo drunore në Kosovë. Të vendosura në kryqëzimin e tri zonave ekologjike, pyjet e Kosovës vlerësohet se strehojnë shumëllojshmëri të pasur të produkteve pyjore jo drunore. Inventarizimi, grumbullimi, përpunimi, ruajtja dhe tregtimi i produkteve pyjore jo drunore të Kosovës, është ndër objektivat kryesore strategjike.

OBJEKTIVI SPECIFIK 3.4: ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM I EKOTURIZMIT

Për shkak të vlerës së lartë rekreative, pyjet e Kosovës ofrojnë mundësi për ekoturizëm, i cili përfaqëson një prej aspekteve të rëndësishme të funksioneve shoqërore dhe ekonomike të pyjeve. Me një planifikim adekuat, ekoturizmi do të shtojë të hyrat nga shërbimet pyjore përmes vizitorëve vendorë e të huaj.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: NGRITJA E KAPACITETEVE

Do të përmirësohen kapacitetet institucionale dhe teknike të sektorit të pylltarisë.

OBJEKTIVI SPECIFIK 4.1: AVANCIMI I ARSIMIT FORMAL NË PYLLTARI

Zhvillimi i kapaciteteve teknike dhe institucionale, lidhet ngushtë me disponueshmërinë e të rinjve për shkollim në pylltari. Me popullsinë më të re në Evropë, Kosova ka një avantazh të dukshëm për të

përfitur nga burimet njerëzore, duke rishikuar dhe mbështetur sistemin ekzistues të arsimit formal dhe duke ofruar mundësi për punësim si në shërbimin publik, ashtu edhe në sektorin privat.

OBJEKTIVI SPECIFIK 4.2: KRIJIMI I MUNDËSIVE PËR AFTËSIM PROFESIONAL

Aftësimi profesional është gjithashtu i rëndësishëm për të ndërtuar kapacitetet e shërbimit publik. Trajnimi i aplikuar, zhvillimi i aftësive dhe qasja e lehtë në teknologjitë digjitale, do të çojnë në praktika më inovative që do të mundësojnë që institucionet e lidhura me pyjet të përballen me problemet në mënyrë efektive dhe të përmirësojnë cilësinë e punës së kryer.

OBJEKTIVI SPECIFIK 4.3: FUQIZIMI I INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE PËR ADMINISTRIM DHE MENAXHIM TË PYJEVE DHE GJUETISË

Funksionimi i rregullt dhe efikas i institucioneve që ndërlidhen me pylltarinë dhe gjuetinë, është një domosdoshmëri kryesore në mbikëqyrjen, monitorimin dhe kontrollin e aktiviteteve të pylltarisë. Duhet të rishikohet struktura organizative dhe menaxhuese e Agjencisë Pyjore, si dhe rolet dhe përgjegjësitë e komunave dhe të institucioneve të tjera publike që ndërlidhen me pylltarinë, të identifikohen mbivendosjet juridiksionale, boshllëqet dhe dobësitë, si dhe të merren masat e nevojshme për fuqizim institucional. Për çështjet ndër-sektoriale, të tilla si gjuetia, çështjet gjinore dhe ekoturizmi, duhet të krijohen sisteme të nevojshme të koordinimit dhe bashkëpunimit ligjor.

OBJEKTIVI SPECIFIK 4.4: SEKTORI PRIVAT MBËSHTETET FINANCIARISHT DHE ADMINISTRATIVISHT

Sektori privat i fuqishëm dhe financiarisht i qëndrueshëm, jo vetëm që do të kontribuojë në ekonominë kombëtare të Kosovës, por edhe do të nxisë zhvillimin e shpejtë të sektorit të pylltarisë. Sektori privat, në veçanti industria pyjore dhe pronarët e pyjeve, do të mbështeten financiarisht dhe administrativisht sikur edhe me masa të tjera stimuluese, për të mundësuar më shumë në ekonominë e gjelbër.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 5: DIGJITALIZIMI DHE KOMUNIKIMI

Të dhënat për pyjet e digjitalizuara, transparenca e përmirësuar, palët e interesit dhe publiku, përfshihen aktivisht dhe kontribuojnë në menaxhimin e pyjeve.

OBJEKTIVI SPECIFIK 5.1: SISTEMI I INFORMACIONIT PYJOR ËSHTË FUNKSIONAL

Kosova ka një Strategji të Qeverisjes Elektronike. MBPZHR dhe APK, janë duke krijuar një sistem informativ pyjor për t'u përdorur për planifikim efikas dhe efektiv të menaxhimit të pyjeve, procese vendimmarrëse, pjesëmarrje të publikut dhe shkëmbim të njohurive. Megjithatë, për shkak të mungesës së burimeve, modulet e sistemit që kanë të bëjnë me pyjet ende nuk janë funksionalizuar. Sistemi informativ pyjor i bazuar në GIS, duhet të dizajnohet dhe pajiset me mjete që do të ndihmonin APK-në, dhe palët e tjera të interesit, duke përfshirë qarqet shkencore, që të kenë të dhëna të sakta dhe në kohë për t'u përdorur në pothuajse çdo aspekt të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve.

OBJEKTIVI SPECIFIK 5.2: AVANCIMI I KOMUNIKIMIT DHE NDËRGJEGJËSIMIT NË PYLLTARI

Komunikimi i dobët dhe keqinformimi, kanë rezultuar në perceptime të gabuara të ndërlidhura me pyjet tek shoqëritë dhe institucionet kryesore sektoriale në të gjithë botën. Hendeku në rritje ndërmjet perceptimeve dhe realitetit, ka ndikuar negativisht në zhvillimin e pyjeve në shumë vende. Duhet të komunikojmë me mençuri dhe t'i informojmë vërtet shoqërinë dhe subjektet jo pyjore, në veçanti për të eliminuar perceptimet e gabuara dhe për të marrë mbështetjen e tyre për menaxhim të qëndrueshëm dhe shumëqëllimor të pyjeve. MBPZHR e ka hartuar një strategji komunikimi për sektorin e pylltarisë së bashku me një plan veprimi. Plani i veprimit i kësaj strategjie për komunikim, do të konsiderohet për zbatim.

5. ZBATIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Qeveria e Kosovës është autoriteti më i lartë për mbikëqyrjen e zbatimit të Strategjisë për Sektorin e Pylltarisë. Qeveria do të ruajë dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë e sektorit duke ofruar një kornizë mbështetëse rregullative dhe institucionale, si dhe do të sigurojë mekanizmat e përhershëm të financimit.

Ministria përgjegjëse për Pylltari është institucioni kryesor për zbatimin e Strategjisë. Ministria, përmes dy nën-njësiteve të saj të pylltarisë (Departamenti i Pylltarisë dhe Agjencia Pyjore e Kosovës) do të zbatojë, monitorojë dhe raportojë aktivitetet. Ministria dhe njësitë e saj të pylltarisë do të bashkëpunojnë ngushtë me ministritë e linjës, ndër të cilat ministria përgjegjëse për mjedis, është veçanërisht e rëndësishme, si dhe institucionet e tjera përkatëse. Komunitet dhe Asociacioni Kombëtar i Pronarëve të Pyjeve Private, luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në arritjen e synimit të përgjithshëm të Strategjisë.

Strategjia është hartuar për një periudhë të caktuar (2022-2030), ndërsa plani i saj i veprimit përgatitet çdo tri vjet. Monitorimi dhe vlerësimi i aktiviteteve janë planifikuar të kryhen në fund të secilës periudhë zbatimi sipas planit të veprimit (në çdo 3 vjet), ndërsa rezultatet e tyre do të formojnë planin e veprimit për periudhën e ardhshme të zbatimit.

Vlerësimi i aktiviteteve, si dhe i gjendjes dhe trendëve të sektorit të pylltarisë në Kosovë, do të vihet nga një Bord Këshillimor Kombëtar për menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve, i cili do të krijohet. Bordi do të përbëhet nga përfaqësues përgjegjës të nivelit të lartë të palëve të interesit të listuar në Kapitullin 4 të këtij dokumenti. Puna e sekretarisë do të kryhet nga Departamenti i Pylltarisë. Bordi Këshillimor Kombëtar i MQP-së, do t'i shqyrtojë raportet e punëtorive me panele, ku do të vlerësohet zbatimi i Strategjisë dhe trendi i përgjithshëm i gjendjes së sektorit pyjor në mënyrë pjesëmarrëse përmes kriterëve dhe treguesve MQP. Bordi do të miratojë dhe do të publikojë raportin kombëtar një vjeçar mbi MQP-në, për Kosovën. Ky raport gjithashtu do të përmbajë rekomandime për rregullimet e ardhshme, duke përfshirë përditësimin e Strategjisë për Sektorin e Pylltarisë.

6. NDIKIMI BUXHETOR I ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Planifikimi financiar për zbatimin e Strategjisë për Zhvillimin e Sektorit të Pylltarisë 2022-2030 synon realizimin e objektivave të përgjithshme dhe objektivave specifike të planifikuara me dokumentin në fjalë dhe realizimin e rritjes së kontributit të sektorit të pylltarisë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, social dhe mjedisor.

Ndikimi buxhetor dhe aspekti financiar i zbatimit të Strategjisë për Zhvillimin e Sektorit të Pylltarisë 2022-2030, është diskutuar gjatë punës dhe konsultimeve të grupit dhe nëngrupeve punuese, shqyrtimit dhe analizimit të dokumenteve: "Programi i Qeverisë së Republikës Kosovës 2021 – 2025", "Planit Strategjik dhe Operacional 2021-2025 i Qeverisë së Republikës së Kosovës", "Korniza Afatmesme Buxhetore 2021-2024" dhe projekteve që janë financuar nga organizatat donatore.

Pjesa më e madhe e kostos (rreth 90% e buxhetit), do të përdoret për projekte që do të sigurojnë rehabilitimin e resurseve, zvogëlimin e dëmtimit dhe degradimit të pyjeve, avancimin e planifikimit të menaxhimit, përfshirë edhe menaxhimin shumëfunksional të pyjeve, pyllëzimeve, ripyllëzimeve, trajtimeve silvikulturore të pyjeve, krijimin e mundësive për ofrim të arsimit dhe trajnimeve për

pylltari dhe ngritje të kapaciteteve humane, mbështetje të sektorit privat, rregullimin e vjeljes, përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve pyjore jo drunore (PPJD), ekoturizmin, gjuetinë, etj.

Vlera e përgjithshme e zbatimit të SZHP-së, 2022-2030 është llogaritur të jetë në vlerë prej diku rreth 21,300,000 Euro. Vetëm për periudhën e parë tri vjeçare do të nevojiten 13,360,000.00 EURO. Gjatë kësaj periudhe, Buxheti i Republikës së Kosovës llogaritet të ketë ndikim me 10, 125, 000.00 Euro ose në vlerë më të madhe prej 8,425,000.00 Euro nga KASH-i, ekzistues, i cili është 1,710,000.00 Euro.

Zbatimi i SZHP-së, 2022-2030 do të sigurohet edhe prej kontributeve të siguruara prej donatorëve, të cilët tradicionalisht kanë ofruar mbështetje për pylltarinë e Kosovës. Këto organizata ndërkombëtare dhe shtete donatore, SIDA- Suedi, BE, FAO, JICA, do të vazhdojnë me projekte mbështetëse dhe kontributi i tyre për zbatimin e strategjisë për periudhën e parë tri vjeçare do të jetë në vlerë prej 3,235,000.00 €.

Çështje shumë me rëndësi mbetet edhe ofrimi i mbështetjes të sektorit privat dhe pronarëve të pyjeve private, ndërmarrjeve dhe përpunuesve të prodhimeve pyjore jo drunore. Kjo përkrahje mund të sigurohet duke aplikuar masat mbështetëse (grante dhe subvencione) prej fondeve të BE-së, (IPA deh IPARD) si dhe nga programet shtetërore të Republikës së Kosovës.

VLERËSIMI I KOSTOS SË PËRGJITHSHME TË ZBATIMIT TË SZHP-SË, 2022 – 2030

Objektivat strategjik	Projektet me prioritet	Rezultatet e pritura	Institucionet e ndërlidhura	Vitet	Kostoja EUR
OBJEKTIVI STRATEGJIK I PËRMIRËSIMI I RESURSEVEVE PYJORE	Planifikimi i menaxhimit të resurseve pyjore	Resurset pyjore menaxhohen me plane afatgjate, të integruara, transparente dhe me të dhëna të rifreskuara që kontribuojnë në zhvillimin mjedisor, ekonomik dhe shoqëror të Kosovës	APK, MMPHI, Komunat, APPP, IP	2022-2030	9,500 000
	Shfrytëzimi i qëndrueshëm dhe trajtimi i grumbujve të rinj pyjor	Prodhimtari e ngritur e drurit përmes aplikimit të masave silvikulturore dhe në harmoni me kërkesën për lëndë drunore			
	Monitorimi i shëndetit të pyjeve	Rreziqet nga dëmtuesit dhe sëmundjet e pyjeve janë identifikuar, monitoruar dhe zvogëluar			
OBJEKTIVI STRATEGJIK II MBROJTJA E RESURSEVE PYJORE	Përmirësimi i administrimit dhe konsolidimi i tokave pyjore	Rregullimi i kornizës legale për administrim, pronësi, funksionin dhe kriteret e shfrytëzimit të tokave pyjore dhe pyjeve	MBPZHR, AKK MNPFI, AME	2022-2030	5,900,000
	Grumbullimi i farës dhe prodhimi i materialit fidanor për pyllëzime të sipërfaqeve të zhveshura, ripyllëzime të zonave të degraduara dhe mirëmbajtja e tyre	Sipërfaqja pyjore është rritur dhe janë krijuar grumbuj pyjor kualitativ. Fidanishtet prodhojnë fidanë të llojeve autoktonë sipas rekomandimeve të programit kombëtar			
	Krijimi i sistemit për parandalimin dhe mbrojtjen e pyjeve nga zjarret	Institucionet përgjegjëse janë pajisur me kapacitete dhe mjete për masa preventive dhe luftim për parandalim të zjarreve pyjore në terren			
OBJEKTIVI STRATEGJIK III PËRDORIMI I QËNDRUESHËM DHE SHUMËFUNKSIONAL I RESURSEVE PYJORE	Ligjshmëria e shfrytëzimit të drurit	Planet e menaxhimit të pyjeve zbatohen për prerje të rregullta. Janë përmirësuar kapacitetet për parandalimin e prerjeve jo të rregullta dhe për të identifikuar funksionet dhe përfitimet prej aspekteve socio-ekonomike dhe mjedisore të pyjeve	MBPZHR, MMPHI, APPP, SHPPP, MTNI, Komunat,	2022-2030	1 900 000
	Rregullimi i shfrytëzimit të produkteve pyjore drunore	Inventarizimi i PPPJ-së, është realizuar dhe janë krijuar kapacitete që të zbatojnë edhe udhëzimin administrativ për			

		shfrytëzimin e këtyre produkteve			
	Përmirësimi i peizazhit dhe zhvillimi i ekoturizmit	Janë hartuar plane për përmirësimin e peizazhit pyjor dhe subvencionimin e ekoturizmit			
	Identifikimi i kritereve dhe indikatorëve për menaxhimin shumëfunksional dhe të qëndrueshëm të pyjeve	Janë aprovuar kriteret dhe indikatorët për zbatimin dhe monitorimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve			
OBJEKTIVI STRATEGJIK IV NGRITJA E KAPACITETEVE	Ngritja e kapaciteteve për personelin e pylltarisë dhe digjitalizimi në pylltari	Personeli pyjor i nënshtrohet trajnimeve të rregullta për rifreskimin e njohurive dhe digjitalizim si dhe merr pjesë në iniciativat rajonale dhe ndërkombëtare	MBPZHR, APK, MF, MASHT	2022–2030	2,500 000
	Organizimi i arsimit dhe trajnimeve profesionale për pylltari	Qendra trajnuese, e organizuar për të operuar në gjithë Kosovën, është duke ngritur shkathtësitë e punëtorëve pyjor			
	Krijimi dhe përmirësimi i mundësive për zhvillimin/ndjekjen e arsimit të lartë për pylltari	Të rinjtë kosovarë kanë mundësi për ndjekjen dhe zhvillimin të studimeve për pylltari			
OBJEKTIVI STRATEGJIK V DIGJITALIZIMI DHE KOMUNIKIMI	Zbatimi i planit të veprimit për komunikim dhe informim në sektorin e pylltarisë	Publiku dhe palët e interesit janë të vetëdijshëm për rolin dhe funksionet mjedisore, ekonomike dhe shoqërore të pyjeve	MBPZHR, APK, APPP, SHPPP, Komunitat.	2022–2025	1, 500 000
	Mbështetje për Shoqatat. e Pronarëve të Pyjeve dhe OJQ-të, mjedisore	Pronarë të pyjeve private janë të përfaqësuar e të organizuar dhe palët e interesit përfshihen aktivisht që të kontribuojnë në menaxhimin e pyjeve.			
	Ofrohen informata të vlefshme dhe me kohë për ndërmarrësi në sektorin e pylltarisë	Afaristët janë më të informuar dhe në gjendje të zhvillojnë operacione efikase dhe në përshtatje me mjedisin			

